



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PUKË

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Territorit

Nr. 1367 prot.

Pukë, më 24/10 2022

PROJEKT-VENDIM

Nr. 02, Datë 24/10 2022
PËR

**VENDOSJEN E PLLAKATËS SË NGRITJES SË FLAMURIT NGA MARASH MARK
PALUSHI NË QELËZ**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, nën pika 1.7, shkronja "b", nenit 54, shkronja "ll" dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar); si dhe neni 3, neni 5 pika 1, neni 25, nenit 26 pika 1, të Ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave" (i ndryshuar); Ligjit nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", (i ndryshuar), VKB nr.14, datë 30.06.2020 "Rregullore e funksionimit të Këshillit Bashkiak Pukë", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim kërkesën,

VENDOSI:

1. Të miratojë vendosjen e pllakatës së ngritjes së flamurit nga Marash Mark Palushi në Qelëz me shkrimin: Këtu me datë 8 dhjetor 1912 patrioti Dom Gasper Thaçi në mes të 500 burrave në Kuvend i dorëzon flamurin kombëtar Marash Mark Palushi (Kolgjokaj). Marashi e ngriti flamurin kundër pushtuesve ballkanik në degën e manit të zi dhe u shpall bajraktar. Marashi duke ju drejtuar popullit që ndodhej aty u tha: Vëllazen... Ju falemderit që ma besuet këtë flamur. Këtë flamur të Shqipnisë do ta mbroj me jeten teme. Pesëqint burra të gjithë një zëri iu përgjigjën: *Për këtë flamur e për atdhe,*

E japim jetën si me le.

2. Çdo vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1 të këtij vendimi, shfuqizohet.
3. Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hy në fuqi sipas përcaktimeve të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër.

Hartuesi
Drejtori i Zhvillimit Ekonomik
dhe Administrimit të Territorit

Alda Mema

Juristi

Endrit Kraja

KRYETARI
GJON GJONAJ



**RELACION
PËR
VENDOSJEN E PLLAKATËS SË NGRITJES SË FLAMURIT NGA MARASH MARK
PALUSHI NË QELËZ**

Drejtuar: Këshillit Bashkiak

Të nderuar Këshilltare/Këshilltarë

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), ligjit nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (i ndryshuar), të ligjit nr. 9270/2004 “Për sistemin e adresave” (i ndryshuar), si dhe me qëllim ruajtjen e vlerave kulturore e historike të Pukës e në mbështetje dhe të dokumentave/librave historik për atdhetarët pukjanë si Marash Mark Palushi. Është me rëndësi të madhe, që njerëz të tillë, bajraktar e prijës popullor, të kujtohen me nder për kontributin e vlerat e treguara gjatë kohërave më të vështira të vendit.

Marash Mark Palushi ishte nga një shtëpi fisnike, me emër në të gjithë krahinën. Ishte kryeplak i fshatit e kryetar i këshillit të Kishës së Shën Palit në Qelëz, anëtar aktiv i çetës së Nikoll Currit. Ishte burri që kishte bërë emër për qendrimin antiturk.

Ai gëzon titullin “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) i Bashkisë Pukë me motivacionin “Marash Mark Palushi, (1873-1950) Luftëtar dhe atdhetar i shquar për pavarësinë e vendit dhe ruajtjen e saj nga pushtues të tjerë serbë, malazezë, austrohungarezë e italianë”.

Nga sa më sipër kërkojmë nga ana juaj të miratohet projekt-vendimi “Për vendosjen e pllakatës së ngritjes së flamurit nga Marash Mark Palushi në Qelëz” me shkrimin: Këtu me datë 8 dhjetor 1912 patrioti Dom Gasper Thaçi në mes të 500 burrave në Kuvend i dorëzon flamurin kombëtar Marash Mark Palushi (Kolgjokaj). Marashi e ngriti flamurin kundër pushtuesve ballkanik në degën e manit të zi dhe u shpall bajraktar. Marashi duke ju drejtuar popullit që ndodhej aty u tha: Vëllazen... Ju falemderit që ma besuet këtë flamur. Këtë flamur të Shqipnisë do ta mbroj me jeten teme. Pesëqint burra të gjithë një zëri iu përgjigjën: *Për këtë flamur e për atdhe,*

E japim jetën si me le.

Ju falemderit!

**Hartuesi
Drejtori i Zhvillimit Ekonomik
dhe Administrimit të Territorit
ALDA MEMA**



**KRYETARI
GJON GJONAJ**

